

UDHËZIM
Nr. 27, datë 9.10.2019

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2.8.2, togfjalëshi “25 lekë/kg”, zëvendësohet me togfjalëshin “10 lekë/kg”.

2. Në paragrafin 2.8.8.1 bëhen këto ndryshime:

-Kudo në përmbajtje togfjalëshi “taksa 25 lekë” zëvendësohet me togfjalëshin “taksa 10 lekë”.

-Paragrafi i tretë i katërt dhe gjerat “a”, “b” dhe “c”, shfuqizohen dhe shtohen paragrafët “a”, “b”, “c” dhe “d” me përmbajtjen e mëposhtme:

“a) lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar, të përfshira në kodet nga 3901 deri 3914 të NKM-së, të cilat përdoren si plotësues teknologjik, lëndë të para aditive (agregate lidhëse), apo si material për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si artikuj plastikë. Taksa për lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar do të aplikohet vetëm nëse materialet/artikujt e prodhuar nga këto lëndë të para janë subjekt i llogaritjes së taksës në rast se këto materiale/artikuj do të importohen;

b) lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit (*EPS expanded polystyrene*), të përfshira në kodet nga 3901 deri 3914 të NKM-së, importimi i paneleve, pllakave të polistirenit (*XPS extruder polystyrene*), të përfshira në kodet 3920 30 00 – prej polimereve të stirenit dhe 3921 11 00 – prej polimereve të stirenit, si dhe profileve PVC për prodhimin e dyerve dhe dritareve, të cilat përfshihen në kodin 3916 20 00 – prej polimereve të vinil kloridit, të NKM-së, artikujt të cilët përdoren në industrinë e ndërtimit në funksion të eficiencës së energjisë;

c) lëndët e para në forma primare për prodhimin e sfungjerëve të përfshira në kodet nga 3901 deri 3914 të NKM-së, si dhe importimi i sfungjerit, të klasifikuar në krerët 3920 – pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjerë, prej plastike, jocelulare dhe jo të përforcuara, jo të laminuara të pambështetura apo të pakombinuara në mënyra të ngjashme me materiale të tjera dhe 3921 – pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjerë, prej plastike.

Importimi i artikujve të cilët përdoren në industrinë e mobilierisë të klasifikuara në krerët 3920 – pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjerë, prej plastike, jocelulare dhe jo të përforcuara, jo të laminuara, të pambështetura apo të pakombinuara në mënyra të ngjashme me materiale të tjera dhe 3921 – pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjera, prej plastike, nënkreun 3926 30 -- përshtatjet për mobilieritë dhe kodin 3926 90 97 ---- të tjera.

d) lëndët e para në forma primare me përmbajtje proteinike të forta të përfshira në kodet nga 3901 deri 3914 apo materialet celuloike, sipas kodit 3917 10 – zorrë artificiale (mbajtësit e sallamit) prej proteinave të forta apo prej materialeve celulozike të NKM-së, të cilat përdoren në industrinë e prodhimit të sallameve.”.

3. Në paragrafin 2.8.8.2 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi “e” shfuqizohet.

- Në paragrafët “e” dhe “f”, paragrafi “tremujore dhe”, shfuqizohet.

4. Në paragrafin 2.8.9, bëhen këto ndryshime:

- Kudo në përmbajtje të këtij paragrafi, pas togfjalëshit “për ambalazheve prej plastike/qelq” shtohet togfjalëshi “lëndën e parë, si dhe materialet/artikujt prej plastike”;

- Në paragrafin e parë, në paragrafin e dytë emërtuar “a” dhe paragrafin e katërt, fjala “e/ të ambalazhit”, hiqet.

5. Në paragrafin 2.8.9.1, pas germës “i”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, administrata doganore kërkon me shkrim dokumentacionin e munguar, brenda 7 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Pas depozitimit të dokumentacionit të kërkuar sipas këtij paragrafi, administrata doganore njofton me shkrim, brenda 7 ditëve, tatimpaguesin mbi aplikimin e dorëzuar”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË
DHE FINANCAVE
Anila Denaj